



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 91 Prot.

Tiranë, më datë 10.3.2026

VENDIM  
Nr. 66, datë 10.03.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 10.03.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e Konceptit të sondazhit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit “Godinë shërbimi dhe banimi 13 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Kristaq Boshnjaku”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me zhvillues subjekti “Lori 2007” sh.p.k., me sugjerimin:
  - Sondazhet të kryhen manualisht dhe pa përdorur mjete mekanike;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për realizimin e sondazheve arkeologjike, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për objektin “Godinë shërbimi dhe banimi 13 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitete për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Endri HAXHIU

